

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Trajnim OJTI /Assessor ATSEP”
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv):** 79998000-6 – Shërbime trajnimi; 79632000-3 – Shërbime të trajnimit të personelit
- **Vlera e fondit limit:** 1 666 666 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL SHA ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: *kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: i ndryshuar citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 666,666 leke pa tvsh (40% e fondit limit) ose

2.2.2 Bilancet e viteve 2020, 2021 dhe 2022. miratuar nga organet perkatese shteterore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata ku të kete realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë jo më vogël sa 20 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga *nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*. Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar përvojë e ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare (ISO):

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerisë.
- **ISO 27001-2013**, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerisë.
- **ISO 20000-1:2018**, Sistemi për Menaxhimin e Shërbimeve ose e perditësuar e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalente me to.

Argumentim: *Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u*

kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij. Sistemi i menaxhimit të sigurojë se informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën 1 punonjes të diplomuar në një nga degët (Informatikë/Teknologji-Informacioni/Elektronike) të çertifikuar sipas kërkesave të mëposhtme:

- Të çertifikuar me një çertifikatë ndërkombëtare, si menaxher projekti, në fushën e menaxhimit të projekteve (PMP / PRINCE 2, etj) ose ekuivalente;
- Të çertifikuar për "ITIL Foundation - FONDACIONI ITIL" ose ekuivalente.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Curriculum-Vitae të Instruktorit që do të drejtojë kursin e trajnimit.

Argumentim: Kriteret e mësipërme janë në përputhje me parashikimet e nenit 41 pika 4 dhe pika 6 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) parashikohet se: "a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose"

"Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës"

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

2.3.4 Operatori Ekonomik, duhet të paraqesë Katalog/Broshurë dhe/ose CD me detaje të hollësishme të ambienteve ku do të zhvillohet kursi. (Sipas kërkesave specifike të detajuar në shtojcën 5).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale objekt kontrate.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën dhe afatin kohor për realizimin e kërtij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Shënim: *Përcaktimi i specifikimeve teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikime Teknike

TRAJNIMIN INSTRUKTOR/VLERESUES ATSEP

Përmbajtja

PERSHKRIMI I KURSIT	3
TE PERGJITHSHME	3
DIZENJIMI I KURSIT	3
VLERESIMI I PERFORMANCES	3
OBJEKTIVAT E KURSIT	3
PJESEMARRESIT	4
KURSI FILLON	4
KOHEZGJATJA	4
PERMBAJTJA	4
TEORI	4
SPECIFIKIME TEKNIKE	4
SPECIFIKIME OPERACIONALE	4
TERMAT DHE KUSHTET E PERGJITHSHME	4
RAPORTET DHE VLERESIMI	5
SPECIFIKIMET E TRAJNIMIT	5
SIGURIMI SHENDETESOR	5
TRANSPORTI	5
AKOMODIMI	6

PERSHKRIMI I KURSIT

TE PERGJITHSHME

Përmbajtja e kursit të trajnimit do të jetë në përputhje me Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 193, datë 06.10.2022, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE TË PËRBASHKËTA PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR DHE TË LUNDRIMIT AJROR, SI DHE FUNKSIONET E TJERA TË RRJETIT TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR DHE MBIKËQYRJEN E TYRE“

Kursi i trajnimit për personelin ITVP/VLE ATSEP është dizenuar për të përfutur njohuritë dhe aftësitë themelore për personelin ATSEP të zgjedhur për të ushtruar detyrat e instruktimit dhe vlerësimit të kompetencës të student/ATSEP dhe ATSEP.

“Ofertues” në këtë dokument i referohet shkollës apo akademisë e cila do të zhvillojë kursin e trajnimit sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe “Blerës” i referohet **ALBCONTROL Sh.A.**(Ofrues i Shërbimeve të Lundrimit Ajror)

DIZENJIMI I KURSIT

Kursi i trajnimit duhet të dizenujohet në mënyrë të tillë që ti ofrojë kandidatëve njohuri dhe mjete për të qënë në gjendje të performojnë si instruktorë në vendin e punës gjatë fazave të ndryshme të trajnimit sic janë përcaktuar në dokumentin “3.4.4.1-01 TECH CAS – ATSEP Competency-Based Training and Assessment Manual”. Gjithashtu, trajnimi duhet të ofrojë njohuri mbi aftësitë e kërkuara për vlerësimin fillestar të kompetencës të personelit student/ATSEP apo gjatë kompetencës së vazhdueshme të ATSEP.

Ofertuesi duhet të sigurojë instruktorë me eksperiencë dhe të kualifikuar për ofrimin e trajnimit të kërkuar, si dhe një set me material trajnimi për kandidatët.

VLERESIMI I PERFORMANCES

Kandidatët do të vlerësohen sipas metodologjisë se “Ofruesit” por të paktën një herë në mbarim të trajnimit.

Rezultati minimal i pranueshëm në test do të jetë përfundim me sukses i kursit të trajnimit.

OBJEKTIVAT E KURSIT

Pas mbarimit të kursit kandidatët do të ketë njohuri dhe kuptueshmëri të temave të përshkruara në përputhje me kërkesat e Urdhërit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 193, datë 06.10.2022, ANNEX XIII - Part-PERS.

PJESEMARRESIT

Kursi është planifikuar për 4 ATSEP.

Kandidatët janë instruktorë ATSEP të cilët kanë njohuri në përgatitjen e moduleve teorike të trajnimit.

KURSI FILLON

Koha e përshtatshme për fillimin e trajnimit: Qershor-Gusht 2023.

Per shkak te nevojave operacionale, zhvillimi i kursit konsiderohet te kryhet sa më shpejt të jetë e mundur pas nënshkrimit të kontratës midis palëve.

KOHEZGJATJA

5 ditë (Propozim i ALBCONTROL) në varësi të planit të trajnimit.

PERMBAJTJA

TEORI

Teoria do të përmbajë subjektet më poshtë:

- Aplikimi I praktikave më të mira të teknikave të instruktazhit dhe mësimi;
- Kuptueshmëri mbi masat e pa-rrezikshmërisë kur punohet në mjedis operacional;
- Njohuri mbi proceset mësimdhënëse, motivimin;
- Kuptueshmëri mbi aftësitë komunikuese verbale dhe joverbale, aftësitë për të dëgjuar;
- Kuptueshmëri mbi rëndësinë e marëdhënieve ndërpersonale, sjelljeve personale apo zgjidhje konfliktesh;
- Njohuri mbi praktikat e trajnimit, informimi i studentit, monitorimin e progresit, metodat e ndërhyrjes;
- Njohuri mbi ndërtimin e ushtrimeve praktike për studentët;
- Si të veprohet kur vlerësojmë ATSEP në mjedis operacional;
- Roli dhe përgjegjësitë e Vlerësuesit të kompetencës;
- Njohuri sit ë vlerëhet me objektivitet kompetenca e stafit;
- Njohuri mbi veprimet e mundshme kur kompetenca e ATSEP është në dyshim, etj.

Ofruesi mund të sugjerojë subjekte shtesë në mësim-dhënie me aprovimin paraprak të Blerësit.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Ushtrime të ndryshme të simuluar duke përdorur sisteme/pajisje trajnimi të avancuara duhet të zhvillohen për familiarizimin e kandidatëve me metodat e instruktimit apo vlerësimit ATSEP. Disa leksione mund të modifikohen për të reflektuar sa më mirë kërkesat e **“Blerësit”**.

SPECIFIKIME OPERACIONALE

TERMAT DHE KUSHTET E PERGJITHSHME

“Ofruesi” do te jetë përgjegjës për të garantuar arritjen e objektivave të trajnimit .

Në mënyrë që të demonstrojë cilësinë e shërbimit, **“Ofruesit”** i kerkohet që të paraqesë dhe të verë në dispozicion të **“Blerësit”** :

1. Një broshurë prezantimi dhe/ose CD me detajet për sa i përket ambjenteve në të cilat kursi i trajnimit do të zhvillohet.
2. Informacion të detajuar mbi eksperiencat trajnimi të ngjashme të zhvilluara.
3. Curriculum-Vitae të Instruktorëve që do të drejtojnë kursin e trajnimit.
4. Ambjentet e trajnimit ku do të zhvillohet pjesa teorike, pajisur me kompjuter dhe me të gjitha mjetet e duhura në funksion të trajnimit, është përgjegjësia e **“Blerësit”**.

5. Prezantim i modulit të trajnimit duhet ti dërgohet **“Blerësit”**. së bashku me programin e trajnimit.

RAPORTET DHE VLERESIMI

1. Kandidatët do të vlerësohen në fund të trajnimit.
2. Formati I vlerësimit do të jetë caktuar nga **“Ofruesi”** për këtë qëllim.
3. Rezultatet përfundimtare duhet të dërgohen në **“Blerësit”**. në rrugë konfidenciale.
4. Një raport objektiv mbi kompetencën e studentit duhet të përpilohet nga **“Ofruesi”**, i cili duhet të përshkruajë pikat e forta dhe të dobëta të kandidatëve,
5. Në mbarim të kursit të trajnimit, **“Ofruesi”** duhet të lëshojë certifikatën origjinale, në të cilën duhet të specifikohet përfundimi me sukses i trajnimit Një kopje e certifikatës duhet ti dërgohet **“Blerësit”**..
6. Në rast të dështimit në ekzaminimin final, ofertuesi duhet ti japë një mundësi të dytë për ri-ekzaminim.
7. Në rast të përsëritjes së dështimit në ri-ekzaminim, një raport duhet ti dërgohet **“Blerësit”**. dhe kursi i trajnimit do të konsiderohet I përfunduar për kandidatin.

Në këtë rast, nga **“Ofruesi”** do të lëshohet vetëm certifikatë pjesëmarrje.

SPECIFIKIMET E TRAJNIMIT

Classroom

SIGURIMI SHENDETESOR

Nuk është i aplikueshëm.

TRANSPORTI

Nuk është i aplikueshëm.

AKOMODIMI

Nuk është i aplikueshëm.